

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7175
E shtunë, 27 prill 2024
Çmimi 0.50

Kërkohet ndihma e qytetarëve për të siguruar mbrojtje të mirëfilltë për Hashim Thaçin | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
 facebook.com Gazeta "Epoka e re"



RAPORTI I IKD-së THOTË SE KUVENDI GJATË 2023-s PATI MUNGESË TË TRANSPARENCËS



Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vlerësuar se Kuvendi i Kosovës gjatë vittit 2023 ka dështuar t'i zbatojë disa nga aspektet kyçë përfunksionim të mirëfilltë, në pajtim me

Kushtetutën dhe me kërkesat ligjore e të Rregullores së Kuvendit. Gjatë prezantimit të raportit me titull "Kuvendi i dështimeve: Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës

për vitin 2023", të premtën, hulumtuesi i lartë nga IKD-ja, Naim Jakaj, ka thënë se puna e Kuvendit është karakterizuar nga vendimmarrja në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës

A PO RREZIKOHET REGJISTRIMI I KOMUNITETIT BOSHNJAK ME TERMINOLOGJINË E GABUAR? F.3



KURTI NË BERLIN
VAZHDOI TAKIMET ME DEPUTETË GJERMANË F.3

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501289
E-mail: renova@m.t.net.mk

PRINCESHA
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

OPINION

HUMBËSIT MË TË MËDHENJ JANË SHQIPTARËT NË MAQEDONI TË VERIUT F.7

Behxhet Sh.
SHALA- BAJGORA



AKTUALE



KRYETARI I PRISHTINËS PRET NË TAKIM BEKIM JASHARIN, DISKUTOJNË PËR SHTATOREN E KOMANDANT ADEM JASHARIT F.7

26 VJET QË NGA DALJA E PARË PUBLIKE E UÇK-së NË DRENOC TË RAHOVECIT F.6

PRINDËRIT KANË ROL KRYESOR NË VAKSINIMIN E FËMIJËVE, T'I MBROJNË ATA NGA SËMUNDJET INFETKIVE F.7

EKONOMI



ABDIKHUKU TAKON 52 AFARISTËT MË TË MËDHENJ NË SHTIME: KOSOVA MUNDET MË MIRË! F.8

PËR TRE MUAJ DIASPORA I DËRGOI 284 MILIONË EURO NË KOSOVË F.8

Xi, Blinkenit: Kina dhe ShBA-ja duhet të jenë partnerë dhe jo rivalë

BEIJING, 26 PRILL - Presidenti kinez Xi Jinping të premten i ka thënë kryediplomatit amerikan Antony Blinken se dy ekonomitë më të mëdha në botë duhet të jenë partnerë dhe jo rivalë. Blinkeni në Kinë për herë të dytë në më pak se një vit është takuar me politikanë kryesorë kinezë në kryeqytetin Pekin, ku zyrtarët amerikanë kanë thënë se ai do të ngrinte

drejtpërdrejt fusha vendimtare të dallimeve, duke përfshirë Rusinë, Tajvanin dhe tregtinë. Duke takuar Blinkenin, Xi ka thënë se të dy vendet kishin "bërë një përparim pozitiv" që kur ai është takuar me presidentin e ShBA-së, Joe Biden, vitin e kaluar, sipas transmetuesit shtetëror "CCTV". "Të dy vendet duhet të jenë

partnerë, jo rivalë. Ka ende një sëri çështjesh që duhet të zgjidhen dhe ka ende vend për përpjekje të mëtejshme. Shpresojmë që ShBA-ja mund të ketë një pikëpamje pozitive për zhvillimin e Kinës. Kur të zgjidhet ky problem themelor... marrëdhëniet vërtet mund të stabilizohen, të përmirësohen dhe të ecin përpara", ka thënë ai.



BE-ja premton miliona euro për Gazën

Bashkimi Evropian (BE) ka thënë se do të japë edhe 68 milionë euro për ndihmën e nevojsme humanitare për palestinezët në Gaza. Ky territor është shkatërruar nga lufta që ka nisur mbi gjashtë muaj më parë mes Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja, teksa Izraeli po sulmon territorin nga toka dhe ajri në kundërpërgjigje të sulmit vdekjeprurës të Hamasit ndaj Izraelit më 7 tetor. Si pasojë e luftës, popullsia civile prej mbi 2 milionë

banorësh e Gazës ka nevojë për ndihmë humanitare. "Në drithë të përkeqësimit të vazhdueshëm të krizës së rëndë humanitare në Gazë dhe rritjes së kërkave në terren për ndihmë, Komisioni Evropian po rrit fondet për ta financuar mbështetjen për palestinezët e prekur nga lufta që po vazhdon. Kjo mbështetje bën që totali i ndihmës humanitare që BE-ja ka ofruar për palestinezët brenda Gazës dhe në mbarë rajonin më 2024 të arrijë në 193 milionë euro", është thënë në deklaratën e BE-së. BE-ja ka thënë se ndihma e re



do të përqendrohet në dërgesat ushqimore, ujë të pastër, strehim dhe do të dërgohet në terren përmes partnerëve lokalë.

Kombet e Bashkuara kanë thënë se operacioni i Izraelit e ka shndërruar Gazën në një "ferr humanitar", teksha është rritur frika për përhapjen e urisë. BE-ja dhe ShBA-ja i kanë kërkuar Izraelit ta lejojnë hyrjen e më shumë ndihmave në Gaza. Ushtria amerikane ka thënë të enjten se do ta nisë ndërtimin e një porti, në mënyrë që të rriten dërgesat me ndihmë humanitare në Gaza.

Raportohet se Spanja do t'i dërgojë Ukrainës raketa kundërajrore



MADRID, 26 PRILL - Spanja do t'ia dërgojë Ukrainës një numër të vogël të raketave kundërajrore të sistemit "Patriot", pas trysnisë nga aleatët e saj në Bashkimin Evropian dhe në NATO, për t'i dhënë Kievit më shumë ndihmë ushtarake. Duke qenë se Rusia i ka shpeshtuar dukshëm sulmet ajrore në Ukrainë, qeverive të BE-së u është kërkuar ta ndihmojnë Kievin me më shumë kundërajrorë për ta mbrojtur veten. Në veçantë kjo vendeve si Greqia dhe Spanja, të cilat kanë armë të tilla në

arsenalini e tyre. Duke i cituar burimet qeveritare, gazeta "El País" raportoi se Spanja e ka hedhur poshtë mundësinë t'i dërgojë Ukrainës sisteme kundërajrore "Patriot", por ka thënë se do ta furnizojë atë me raketë që përdoren nga ky sistem kundërajror. Vendet evropiane, të cilat zotërojnë sisteme kundërajrore "Patriot", po ngurrojnë t'ia jepin Ukrainës ndonjë prej tyre. Ukraina ka shumë nevojë për së paku shtatë "Patriotë" për t'i frenuar sulmet ajrore ruse. Forca ajrore e Rúsie është

shumë më e fuqishme se ajo e Ukrainës, por kundërajrorët e sofistikuar të aleatëve perëndimore të Kievit mund të përbëjnë kërcënëm të madh për aviacionin rus.

"Patriotë" janë kundërajrorë raketorë të cilët mund t'i godasin avionët luftarakë, raketat lundruese dhe raketat balistike me reze të shkurtra veprimi. Përparsi e rëndësishme e këtyre kundërajrorëve të prodhuar nga ShBA-ja, përvëç efikasitetit të tyre, është edhe fakti se trupat ukrainase janë të stërvitura se si t'i përdorin ata.

Zyrtari i OKB-së: Mund të nevojiten 14 vjet për ta pastruar Gazën nga mbeturinat

GJENEVË, 26 PRILL - Mund të nevojiten rrëth 14 vjet për ta pastruar Rripin e Gazës nga mbeturinat, përfshirë mjetet e pashpërthyera, që janë lënë nga lufta shkatërruese e Izraelit, ka thënë të premten një zyrtar i Kombeve të Bashkuara.

Lufta tokësore dhe ajrore e Izraelit kundër Hamasit - grupit të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet te Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - e ka rrënuar shumicën e territorit të vogël bregdetar me 2.3 milionë banorë, duke i lënë shumicën e

civilëve të pastrehë, të uritur dhe të rrezikuar nga sëmundjet.

Pehr Lodhammar, zyrtar i lartë i OKB-së për veprim kundër minave (UNMAS), ka thënë të premten në Gjenevë se lufta e ka mbushur me 37 miliardë tonë mbeturina territorin e mbipopulluar palestinez.

Ai ka thënë se, edhe pse nuk është e mundur të dihet numri i saktë i mjeteve të pashpërthyera në Gazë, është parashikuar se mund të nevojiten 14 vjet sipas kushteve të caktuara për t'i hequr

mbeturinat, përfshirë dhe gërmadhat e ndërtesave të rrënuara. "Ne e dimë se ekziston një shkallë e dëshimit prej 10-përqindësh të munizioneve tokësore që po shkrepën dhe nuk po shpërthejnë. Po flasim për rrëth 14 vjet punë me 100 traktorë", ka thënë ai. Lufta e Izraelit në Gaza kundër Hamasit nisi pasi pjesëtarët e këtij grapi i vranë rrëth 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe i rrëmbyen rrëth 250 të tjerë gjatë atij sulmi në jug të Izraelit. Më shumë se 34 000 palestinezë janë vrasë, prej të cilëve dy e treta fëmijë dhe gra, si pasojë e luftës izraelite në Gazë prej atëherë, sipas zyrtarëve shëndetësorë palestinezë.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

- Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
- ADRESA: Prishtinë, përbalë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
- Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kërkohet ndihma e qytetarëve për të sigruar mbrojtje të mirëfilltë për Hashim Thaçin

PRISHTINË, 26 PRILL - Fondacioni "Përkrahje për Mbrojtjen Juridike të Hashim Thaçit" ka kërkuar ndihmën e qytetarëve për mbrojtjen e duhur për ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, i cili prej vitesh gjendet në paraburgim.

Në njoftimin e këtij fondacioni është thënë se mbështetja financiare është e nevojshme për një mbrojtje të mirëfilltë juridike. "Në betejën për të vërtetën dhe drejtësinë në Hagë, Hashim Thaçit i duhet përkrahja juaj! Ndihamoni edhe ju për t'i sigruar mbështetje financiare që i mundëson mbrojtje të mirëfilltë juridike", është thënë një njoftimin e publikuar në Facebook".

Më 19 janar të këtij viti avokatët kryesorë të mbrojtjes së Hashim Thaçit, pranë Dhomave të Specializuara në Hagë, Gregory Kehoe, Joe Reeder, "Greenberg Legal Associates" dhe anëtarët e kësaj kompanie, kanë kërkuar të tërhoqen në rastin e tij në Gjykatën Speciale në Hagë, kudhe më vonë



janë larguar. Në kërkesën e tyre ndaj Dhomave të Specializuara në Hagë është përmendur moskryerja e obligimeve ndaj tyre nga ana e institucioneve të Kosovës.

Vëllai i ish-presidentit Thaçi, Idriz Thaçi, duke e falënderuar avokatin Kehoe dhe ekipin e tij për angazhimin e deritashëm, kishte sqaruar se kontrata me kompaninë ligjore "Greenberg Legal Associates" nuk është vazhduar për shkak të vështirësive financiare. Kujtojmë se Hashim Thaçi së bashku me Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin gjenden në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar në muajin prill të vitit 2023.

HASHIM THAÇIT I DUHET PËRKRAHJA JUAJ!

KOSOVË

Titullari i Llogarisë

PMJHTH, Përkrahje për Mbrojtjen Juridike të Hashim Thaçit

SWIFT CODE

EKOMXKPRXXX

Nr. Llogarisë

1401000001722802

IBAN

XK051401000001722802



Kurti në Berlin vazhdoi takimet me deputetë gjermanë

BERLIN, 26 PRILL - Në ditën e dytë të qëndrimit në kryeqytetin e Gjermanisë, kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti, bashkë me ambasadorin e Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti, vazhdoi takimet me përfaqësues politikë dhe deputetë të Bundestagut.

Bashkëbisedoi me dhjetëra deputetë të Partisë Socialdemokrate (SPD), të Bashkimit Demokristian (CDU), të Partisë së Gjelbër (Grüne) dhe të Partisë së Lirë Demokratike



(FDP). Takimet i filloj me dr. Rolf

Mützenich, deputetin dhe kryetarin e Grupit Parlamentar të

SPD-së. Kryeministri e falënderoi atë për ftesën që të marrë pjesë në ngjarjen e organizuar mbrëmë nga SPD në shënim të 75-vjetorit të Këshillit të Evropës.

Ndërkohë në një drekë pune takoi deputetët Michael Roth (SPD), Andreas Schwarz (SPD), Knut Abraham, (CDU), Michael Brand (CDU), Jürgen Hardt (CDU), Volkmar Klein (CDU), Volker Ulrich (CDU), Philip Krämer (Grüne), Max Lucks (Grüne), Boris Mijatovic (Grüne), Ulrich Lechte (FDP) dhe Thomas Hacker (FDP). Tema kryesore e bashkëbisedimeve ishte aplikimi i

Kosovës në Këshillin e Evropës dhe rruga drejt anëtarësimit të plotë në këtë organizatë.

Krahas mirënjojës përmështetjet e deritanishme ndaj vendit tonë, kryeministri Kurti u bëri thirrje deputetëve gjermanë dhe qeverisë gjermane të vazhdojnë ta përkrahin Kosovën edhe në hapin e fundit, mbi bazën e opinionit të raportueses Dora Bakoyannis, votës historike të Asambleës Parlamentare të Këshillit të Evropës më 16 prill dhe regjistrat të kornizës ligjore, të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë në Kosovë.

Kosova ka mbajtur për herë të parë tryezën rajonale për partneritetet publiko-private

PRISHTINË, 26 PRILL - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bashkëpunim me SIGMA, ka organizuar tryezën e parë rajonale me temë avancimin e partneriteteve publiko-private. Kjo tryezë shërbeu si platformë e diskutimeve ndërmjet politikëbërësve, përfaqësuesve të institucioneve financiare dhe ekspertëve nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Turqia.

Pjesë e kësaj tryze ishin zëvendësministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Avni Zogiani, drejtori i Departamentit Qendror të PPP Arton Ahmeti, drejtori i Planifikimit në Departamentin e Koncesioneve në ATRAKO - Shqipëri, Besart Buza, asistent-drejtori në Agjencinë e Investimeve në Malin e Zi, Andrej Lakic, drejtori i Qendrës së PPP në Stamboll, dr. Eyüp Vural Aydin, si dhe

ekspertët nga SIGMA. Përgjatë dy ditëve të konferencës përfaqësuesit e shteteve të pranishme kanë ndarë eksperiencat, sfidat dhe rekomandimet e tyre përzbatimin efektiv të modelit të PPP në rajon. Gjithashtu, pjesëmarrësit diskutuan për sektorët më të përshtatshëm përzbatimin e projekteve të llojut PPP dhe hartuan disa rekomandime përzbatimin e këtyre projekteve në të ardhmen.





A po rrezikohet regjistrimi i komunitetit boshnjak me terminologjinë e gabuar?

PRISHTINË, 26 PRILL - Komuniteti boshnjak në Kosovë shfaq drojën se numri i tij mund të zgjelohet për shkak të parregullsive të evidentuara gjatë procesit të regjistrimit të popullsisë, i cili nisi më 5 prill dhe do të vazhdojë deri më 17 maj.

Këto parregullsi i referohen pyetjes në pyetësorin në gjuhën serbe: "Cilit grup etnik i përkisni", e në të cilin një prej përgjigjeve është "bosanac" në vend të "boshnjak".

Boshnjakët janë një prej komuniteteve pakicë të njohura me Kushtetutë në Kosovë, ndërsa termi "bosanac" i referohet dikujt që jeton në territorin e Bosnjë-Hercegovinës.

Pyetësorët janë në disposicion në dy gjuhë zyrtare: shqip dhe serbisht.

Fahret Sijariq, pjesëtar i komunitetit boshnjak nga Peja, tregon për "Radion Evropa e Lirë" se regjistruesit shkuan tek ai tri ditë më parë për ta kryer regjistrimin dhe se ata kishin pyetësor në gjuhën shqipe.

Duke qenë se nuk i kuptonte disa pyetje, ai kërkoi pyetësor në gjuhën serbe. "Por, në formularin në gjuhën serbe figuronte 'bosanac' si opson i përkatësisë etnike dhe nuk desha të vazhdoj", thotë Sijariq.

Ai tregon se disa anëtarë të familjes dhe fqinjë të tij refuzuan të regjistrohen pikërisht për shkak të këtij gabimi në pyetësorët në

gjuhën serbe. "Ky regjistrim duket si një turne futbolli. Hajde, luajmë, nënskrumjë dhe tung", shprehet Sijariq.

Gazetari Mustafa Bale, i cili vjen nga komuniteti boshnjak dhe përcjell regjistrimin e popullsisë në Kosovë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se disa boshnjakë, "nga revolta", u kanë thënë regjistruesve ta shënojnë opsonin "të tjerë".

Në këto raste, sipas tij, boshnjakët regjistrohen si komunitetë të tjera pakicë në Kosovë të cilat nuk janë të njohura me Kushtetutë.

Komunitetet pakicë, të njohura me Kushtetutën e Kosovës, janë: serbët, boshnjakët, romët, ashkalintë, egyptianët, goranët dhe turqit. Ato kanë të drejtë të caktuara, si vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës apo të drejtën për arsim, përdorim të gjuhës, kultivim të kulturës, feso dhe traditës.

Zëvendëskryeministria e Kosovës për Çështje të Pakicave dhe të Drejtat e Njeriut, Emillija Rexhepi, në një deklaratë për REL-in ka thënë se ka reaguar urgjentisht ndaj këtyre parregullsive dhe se gabimi është korriguar në Prizren.

Prizren dhe në pjesën e Dragashit ku jeton komuniteti boshnjak. Sipas saj, termi "bosanac" në këto komuna është zëvendësuar me termin "boshnjak" vetëm në pyetësorët elektronikë, të cilët regjistruesit i përdorin në tabletetë e tyre në gjuhën serbe. "Kam bërë

një vërejtje për Pejën dhe Istogun, është korriguar në disa vende, por jo gjithkund ku boshnjakët janë shumicë", tha Rexhepi. REL-i siguroi fotografi të kësaj parregullsie në tabletët e regjistruesve, të cilat më pas, më 17 prill, u korriguan në disa zona ku jetojnë boshnjakët.

Megjithatë, Mustafa Bale thotë se gabimi në tabletët që përdorin regjistruesit është korriguar vetëm në Prizren, ndërsa në komuna të tjera ku jetojnë pjesëtarë të komunitetit boshnjak - si Dragashi dhe Peja - regjistruesit e kanë ende opsonin "bosanac" si opson për përkatësinë etnike.

Më 24 prill organizata joeveritare Këshilli i Kongresit të Intelektualëve Boshnjakë të Kosovës e njoftoi Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) se gabimi nuk është korriguar as në Dragash dhe as në Pejë. "Disa qytetarë po i kthejnë regjistruesit për shkak se nuk e kanë të shënuar përkatësinë kombëtare", thuhet në letrën e kësaj organizate drejtuar ASK-së, e cila u nënskrua nga Mejdin Saliji nga Prizreni.

Organizata kërkoi nga ASK-ja ta korrigojë menjëherë gabimin në mënyrë që "regjistrimi të ketë këtë kuptim dhe të gjithë qytetarët të shprehen ashtu siç e ndiejnë".

REL-i e pyeti ASK-në për këto parregullsi, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk

mori përgjigje.

Mejdin Saliji thotë se anëtarët e organizatës joeveritare Këshilli i Kongresit të Intelektualëve Boshnjakë të Kosovës janë vazhdëmisht në terren dhe se monitorojnë regjistrimin e popullsisë. Sipas tij, ata kanë informacione se gabimi në lidhje me përkatësinë etnike të boshnjakëve nuk është korriguar kudo.

Ai shton se me këtë rast janë mbajtur debate publike në Prizren dhe në Pejë dhe se kanë marrë informacione se disa regjistrues nga komuniteti boshnjak kanë refuzuar ta bëjnë regjistrimin derisa të korrigohen gabimi në pyetësor. "Është ndoshta problem rrëth gjuhës [v.] përkthimi", por kjo do të thotë shumë për ne boshnjakët, sepse mund të ndodhë që kur të përditësohen të dhënat, të figurojnë dy komunitete: bosancat dhe boshnjakët", thotë Saliji.

Ai thotë, po ashtu, se ka një numër boshnjakësh që refuzojnë të regjistrohen dhe se kjo ka "pasoja katastrofike" për komunitetin.

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011, në Kosovë jetojnë rrëth 27 000 boshnjakë. Por, gazetari Mustafa Bale thotë se regjistrimi në veri të Kosovës nuk është bërë atëherë dhe se, sipas disa vlerësimeve, janë rrëth 30 000 pjesëtarë të

komunitetit boshnjak. Ai beson se regjistrimi në zonat ku jetojnë boshnjakët duhet të përsëritet ose të zgjatet sepse, siç thotë, procesi është vonuar për shkak të gabimeve në pyetësor.

Në të kundërtën, thotë Bale, të drejtat kolektive të këtij komuniteti janë në rrezik. "Kjo do të ndikojë në të drejtat e garantuara, në të drejtën për ta përdorur gjuhën, në të drejtën për të mbajtur mësim në gjuhën boshnjake", thotë ai.

Bale dhe Saliji thonë, gjithashtu, se një numër i madh i pjesëtarëve të komunitetit boshnjak jetojnë në diasporë dhe se as atyre nuk u është mundësuar të deklarohen për përkatësinë e tyre etnike.

Agjencia e Statistikave të Kosovës e ka bërë të mundur regjistrimin e familjarëve që jetojnë jashtë Kosovës, por aty nuk ka mundësi që dikush të deklarohet se cilët grup etnik i përk.

Çfarë thonë përfaqësuesit politikë të boshnjakëve?

Zëvendëskryeministra Emillija Rexhepi nga radhët e Partisë së Re Demokratike (NDS), pjesë e Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, thotë se komunitetit boshnjak i është bërë thirje që të mos i përgjigjet regjistrimit derisa të korrigohen gabimet, ndërsa bën me dije se ka informacione se

Raporti i IKD-së thotë se Kuvendi gjatë 2023-s pati mungesë të transparencës

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vlerësuar se Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2023 ka dështuar t'i zbatojë disa nga aspektet kyçë për funksionim të mirëfilltë, në pajtim me Kushtetutën dhe me kërkesat ligjore e të Rregullores së Kuvendit. Gjatë prezantimit të raportit me titull "Kuvendi i dështimeve: Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2023", të premten hulumtuesi i lartë nga IKD-ja, Naim Jakaj, ka thënë se puna e Kuvendit është karakterizuar nga vendimmarrja në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës

EPOKA
E BE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 PRILL - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), ka organizuar të premten konferencë për medie, në të cilën ka publikuar raportin “Kuvendi i dështimeve: Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2023”. Ky raport përfshin gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet si rezultat i monitorimit sistematik të bërë në Kuvendin e Kosovës.

Hulumtuesi i lartë nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Naim Jakaj, ka thënë se Kuvendi i Kosovës zhvilloi punime në tri raste pa e miratuar rendin e ditës. Gjatë prezantimit të rapportit, Jakaj

ka thënë se IKD-ja ka gjetur se kryeparlamentari Glauk Konjufca interpretoi gabimisht Rregulloren e Kuvendit për mosfillimin dhe mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme për arsy se në sallë nuk ishin të pranishëm 61 deputetë. "Sa i përket respektimit të procedurave në pajtim me rregulloren e Kuvendit, IKD-ja gjen se në tri raste Kuvendi i Kosovës zhvilloi punime pa miratuar rendin e ditës në seancë plenare, për arsy se ky rend i ditës nuk u votua në Kryesinë e Kuvendit në mungesë të kuorumi", ka thënë Jakaj. Sipas tij, IKD-ja vlerëson se kuorumi në seancë plenare është i domosdoshëm dhe i patejkalueshëm për votimin e

projektligjeve dhe akteve të tjera të Kuvendit, por kuorumi nuk duhet të jetë pengesë për zhvillimin e debatit parlamentar, veçanërisht kur ajo është e thirrur nga 1/3 e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, bashkësi deputetësh që me Kushtetutë kanë të drejtën e propozimit edhe të amendamenteve kushtetuese. Ai ka thënë se edhe gjatë vitit 2023 Kuvendi ka vazhduar të përballet me mungesë të thellë të transparencës. "Që nga publikimi i gjetjeve në raportin për punën e Kuvendit gjatë vitit 2022 nuk është bërë lëvizje e duhur dhe pozitive në drejtim të publikimit të të gjitha materialeve me rastin e mbajtjes së një seance parlamentare", është shprehur Jakaj. Po ashtu, ai ka thënë se komisionet parlamentare i mbajnë mbledhjet e hapura, por vazhdojnë të mos transmetohen përmes faqes zyrtare të Kuvendit, përmes Radio Televizionit të Kosovës ose edhe përmes ndonjë entiteti tjeter siç janë agjencitë e lajmeve. "Përkundër premtimit që votimi elektronik do të zgjidhet shpejt, Kuvendi ka dëshuar që këtë cështje ta

rregullojë", ka deklaruar Jakaj. Ndërsa për shkak të mungesës së votimit elektronik, Jakaj ka theksuar se shpeshherë ka ndodhur që numërimi i votave të mos jetë i saktë dhe të përsëritet më shumë se dy herë dhe sërisht të mos jetë i qartë në fund rezultati. Në anën tjetër, ai ka thënë se Kuvendi vazhdon të mos respektojë rregulloren me rastin e publikimit të votës së deputetëve, ku e njëjta rregullore kërkon që votimi me dorë të bëhet publik menjëherë pas përfundimit të seancës plenare. Një nga të gjeturat e këtij raporti, sipas Jakajt, është që puna e Kuvendit është përcjellë edhe nga gjuha joparlamentare, gjuha seksiste, raciste, mizogjene dhe gjuha homofobe. "Kuvendi ka zhluar punime pa planifikim adekuat", ka thënë Jakaj. Sipas tij, Kuvendi e nisi vitin 2023 me tetë seanca plenare të papërfunduara nga viti 2022, me gjithsej 54 pikë të rendit të ditës, në ndërkokë viti 2023 u përmbyll me 30 pikë të papërfunduara të cilat u bartën në vitin 2024. Raporti, ndër të tjera, theksion se Qeveria e Kosovës ka injoruar

Kuvendi te pyetjet parlamentare, te komisionet hetimore dhe te debatet parlamentare për të dhënë përgjegjësi për punën e vet kushtetuese dhe për programin qeverisës të cilin e ka shpalosur para deputetëve në mars të vitit 2021.

Në lidhje me aktivitetin legjislativ, Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2023, sipas Jakajt, u pëershkrua me mungesë kronike të kuorumi të Kuvendit. "Në lidhje me aktivitetin legjislativ ai u pëershkrua nga mosefikasiteti i Kuvendit në miratimin e projektligjeve dhe pikave të tjera të rendit të ditës, përgjithësisht ndikim pati mungesa kronike e kuorumi që në shumicën e rasteve u shkaktua nga deputetët e shumicës parlamentare, veçanërisht te projektligjet ku kërkohet shumicë e thjeshtë e votës", ka thënë Jakaj.

Raporti, gjithashtu, potencon se shumica parlamentare në vazhdimi të është treguar arrogante sa i përket bashkëpunimit me deputetët opozitarë për miratimin e Ligjit për Ndarjet Buxhetore Vjetore për vitin 2024.



një numër i madh i pjesëtarëve të këtij komuniteti është regjistruar në dy-tre ditët e fundit. Sipas vlerësimit të saj, vonesat në regjistrimin e komunitetit boshnjak nuk do të ndikojnë në rezultatin përfundimtar sepse, siç thotë ajo, procesi zgjat deri më 17 maj dhe ka kohë që të gjithë të regjistrohen.

"Ne jemi një komunitet i vogël, regjistrimin mund ta përfundojmë për një javë.... Personalisht jam e kënaqur me reagimin e njerëzve tanë, jemi aktivizuar të gjithë, të gjitha subjektet politike, sektori joqeveritar, mediet", thotë Rexhepi.

Qerim Bajrami nga koalicioni Vakat - një subjekt politik boshnjak që është i përfaqësuar në disa institucionë lokale, por edhe qendrore të Kosovës - ka thënë se çështja e terminologjisë ka shkaktuar revoltë në mesin e komunitetit boshnjak dhe se shumë prej pjesëtarëve të tij tani po refuzojnë të regjistrohen. "E rëndësishme është që këtu [në Prizren] ka reaguar edhe kryetari i komunës, që është gjë e mirë. Ai ka kërkuar nga komisioni i regjistrimit t'i korrigojë gabimet, por ato korrigjime kanë zgjatur një javë. Regjistrimi nuk ka filluar derisa janë bërë korrigjet, por ato janë bërë vetëm në komunën

e Prizrenit. Në Dragash gabimi në lidhje me termin boshnjak-bosanac është korrigjuar vetëm pjesërisht. E njëjtë gjë është edhe në komunën e Pejës dhe në komunat e tjera në Kosovë", thotë Bajrami. Ai shton se kanë biseduar me drejtoren e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Avni Kastrati, dhe se janë siguruar se të gjithë ata që janë regjistruar si "bosanac" do të regjistrohen përfundimisht si "boshnjakë". Megjithatë, Bajrami thekson se kjo çështje ka shkaktuar revoltë në mesin e pjesëtarëve të komunitetit boshnjak dhe se shumë prej tyre tanë refuzojnë të regjistrohen.

Gabime të tjera gjuhësore

Në pyetësorët në gjuhën serbe, përveç atyre faktike, ka edhe gabime të shumta gjuhësore që i bëjnë pyetjet të pakuptueshme. Për shembull, në një prej pyetjeve për gjendjen martesore thuhet "burrë/grua me kuroër" dhe "burrë/grua pa kuroër". Zëvendëskryeministria Rexhepi beson se një sërë institucionesh kanë dështuar në përgatitjen e pyetësorit të regjistrimit në gjuhën serbe, duke përfshire edhe organin kryesor përgjegjës

për organizimin e të gjithë procesit, Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Në Kosovë gjuha shqipe dhe ajo serbe janë zyrtare, që do të thotë se institucionet janë të obliguara ta sigurojnë përdorimin e barabartë të këtyre gjuhëve. Gjuhët e komuniteteve të tjera pakicë përdoren, gjithashtu, në nivel lokal në komunat e caktuara, ku ato jetojnë. Megjithatë, Zyra e Komisionarit për Gjuhët, e cila funksionon në Kabinetin e Kryeministrat të Kosovës, tregon shpesh se të drejtat e komuniteteve pakicë shkelen kur bëhet fjalë për përdorimin e gjuhëve.

Humbësit më të mëdhenj janë shqiptarët në Maqedoni të Veriut



**Behxhet Sh. SHALA-
BAJGORA**

Kaluan zgjedhjet presidenciale dhe pritet 8 maji: Albin Kurti i futi hundët në Shqipëri dhe pësoi debakël. Në Luginë të Preshevës e formoi skuadrën e llaskuçëve dhe rrogëtarëve të udhëhequr nga Shaip Kamberi në Luginë dhe Ardita Sinani me Ragmi Mustafi në Prishtinë, e para këshilltare e Albinit, kurse Ragmu i si këshilltar i Besnik Rrencit. Në Mal të Zi nuk dhezi kombinimi me Dritan Abazoviqin, antishqiptarin dhe proserbin e thekur që, sipas udhëzimeve të Amfilohije Radoviqit, e dobësoi substancën malaziase dhe e riktheu ndikimin rus dhe serb. Albini qartazi ka një padurim ndaj atyre që me luftë dhe sakrificë e bënë Kosovën shtet, kështu si është, në radhë të parë ndaj Hashim Thaçit, jo se nuk është pajtuar me të politikisht, por se kishte mungesë të protagonizmit historik. Kishte deficit të theksuar historik krahasuar me Thaçin. Të njëtin mosdurim e ka edhe ndaj Ali Ahmetit i cili, gjithashtu u bë, falë të gjitha luftërave clirintare, pjesë e përjetshme e Pantheonit të shqiptarisë ku renditen të gjithë ata që kontribuuan, deri duke flijuar jetën e tyre, heronjtë dhe

martirët e Kombit. Shqipëria mbaroi paq me Albinin duke e lënë pa asnjë ndikim politik atje. Në Luginë e riktheu ndikimin përmes shkarkimit të Shqiprim Arifit dhe rikthimit të gogolit Mustafa. Aspak nuk e njoh Shqipërim Arifin përvçe se ka përdorur cilësime të rënda për Albinin në vazhdimësi dhe se ka qenë i bojkotuar nga Albini dhe Besnik Rencsi që kanë favorizuar politikisht dhe materialist krahun e rogëtarëve në me krye Shaip Kamberi. Ndoshita Shqipërim Arifi e ka merituar të shkarkohet por më habit fakti se si në vend të tij, si organ i dhunshëm deri në zgjedhje u emërua, pa zgjedhje, Ragmi Mustafa. Realisht, Albini, bashkë me Besnikun dhe "Cetën e Rrogëtarëve" përcau, deri në urrejtje shqiptarët e Luginës. Më herët Albini bëri luftë të hapur kundër Ali Ahmetit duke përdorur një hermafrodit politik dhe kombëtar, me dy shtetësi dhe dy identitetë kombëtare, Blerim Rekën në garë për president të Maqedonisë. Blerim Reka mori vota aq sa nuk i mjftuan as për këshilltar lokal në Lagjen Shute Orizare që shërbyen si trampolinë për një karrierë politike në Amerikë, si konsull i Kosovës, me një pagë të lartë duke tredhur miza tërë kohën, punë që me të njëjtin përkushtim dhe sukses e bënë Gani Jakupi në Barcelonë, i tredhur nga çdo përgjegjësi. Eksperimentin in vitro e vazhdoi me Zijadin Selën deri në kohën kur e kuptoi se Albini po e përdorë si armë qitëse për ta vrarë politikisht Ali Ahmetin. Sela iku dhe në vend të

tij erdhë Bekim Kocja nga Alfabeti i Manastirit që, sikur Arbëri Nagavci nuk i dinte as sa shkronja i ka alfabeti i gjuhës shqipe por se përfituan shumë, analafabetja jofunksionale u bë ministre e arsimtë në Kosovë kurse "vetevendosësi" Qokja u bë këshilltar politik i Albin Kurtit pikërisht për Maqedoninë. Në ndërkokë, të ikurit dhe të përjashtuarit nga BDI-ja e formuan mendermethënë "Grupin e Zjarrit" për t'i vënë flakë Ali Ahmetit dhe shqiptarëve në Maqedoni të Veriut. Izeti, Bilalli, Afrimi dhe kanakari i VMRO-së, Arben Travari, bashkë me LV formuan "grupin opozitar s'VLEN", si rrogëtarë të VMRO-së, për ta rrëzuar Ali Ahmetin dhe për ta luftuar UÇK-në, në emër dhe për llogari të komitave maqedonas. Albini ishte në tubimin promovues në Tetovë, deri në kohën kur "atentatorët" e RTK-së organizuan atentat kundër tij. Falë zotit shpëtoi dhe pa asnjë pasojë u kthyë në Prishtinë përmes autostradës që e ndërtói Hashim Thaçi. Po të njëjtin grup të pordhaxhinje të "Grupit të Zharrit" e priti në Prishtinë në ditën kur varrosej viktima e dhunës në familje. Albini nuk shkoi në Gjermani pasi shteti gjerman nuk garantonte siguri që aspak nuk ishte e vërtetë. Në tubimin zgjedhor në diasporë Albini e dërgoi një ministre të qeverisë Kurti e cila për sa kohë të zgjasë njerëzimit do të mbahet mend për shkak të një fjalimi të Jashtëzakonshëm elektoral që përbëhet vetëm nga katër fjale: "keni përshtëdetje nga Kurti ...". Cfarë thellësie, elokuence dhe

porosie elektorale, thjesht, e paimagjinueshme dhe e papërsërithshme. Antologjike përkah injoranca, poshtëruese përkah nënshtrimi!

Nuk fituan as Osmani e as Travari, por komitat dhe cubat maqedonas: Kandidatja e VMRO-së fitoi thuaja 40 për qind të votave, Pendarovski i Zaevit dikur 20 për qind, Bujar Osmani te 15 përqindëshi kurse Arben Travari te 10 përqindëshi. Në balotazhi shkojnë VMRO dhe LSDM kurse BDI dhe pordhagjinj e "Grupit të Zjarrit" e vazhdojnë luftën vëllavrasëse politike me armatim përcarës të Albin Kurtit. Ka qenë e quartë se shqiptarët nuk kanë gjasa në gara presidenciale por, si një trup i bashkuar, me një listë të përbashkët do të fitonin një 30 deputetë. Në rrethana të përcarjes nga dronët kamikazë të Albin Kurtit në Maqedoni të Veriut roli i shqiptarëve do të marginalizohet duke e humbur peshën politike. BDI-ja mund të fitojë 13 - 15 deputetë, kamikazët e Albinit 7 - 9 deputetë duke u bërë bashkë me VMRO-në. Është pritje reale që Travari të bëhet pjesë e qeverisë së ardhshme të Maqedonisë, jo si fuqi politike por si substancë nënshtruese dhe pa përbajtje kombëtare që aq shumë po pëlqehet nga VMRO-ja e cila nuk e ka as dyshimin më të vogël të përcaktimit midis Ali Ahmetit dhe Arben Travarit. Travari e ka pikërisht këtë qëllim që përmes komitave të VMRO-së dhe llaskuçëve të Albin Kurtit ta zhveshë shqiptarin e Maqedonisë nga çdo vlerë kombëtare duke e shndërruar në

një forcë të papërfillshme politike. Përpjekja e Travarit, Albin Kurtit dhe komitatave të VMRO-së është përpjekje për rishkrim të historisë së këtij shteti duke e përjashtuar dhe dënuar rolin dhe kontributin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare për të cilën nuk e kanë dhënë as kontributin më të vogël pordhaxhinjtë e "Grupit të Zjarrit" e lëre më Albin Kurti. Kështu, me këtë skenar, Serbia dhe Rusia po rikthehen në Maqedoni të Veriut sikur që po rritet ndikimi politik dhe shkombëtarizues i Erdoganit përmes birit të tij politik, Bilall Kasamit. Interesant, edhe biri biologjik i Erdoganit e ka emrin Bilall. Albin Kurti është KM i Kosovës ku punët janë llugë në të gjitha segmentet prandaj nuk ka pasur nevojë t'i fusë hundët në problemet e të tjerëve. Albini as nuk ka pasur nevojë e as që ka nevojë të bëjë dallime midis shqiptarëve duke përkrahur haptas disa dhe duke sulmuar haptas të tjerët. Albini duhet të heq dorë nga ndjenja e Madhështisë së Personalitetit, e të bërit Baba i Shqiptarëve duke e rishkuar historinë e shqiptarëve përmes fredivlbelericave, Gjykatës Speciale Raciste, Rrogëtarëve të Luginës apo Llaskucëve të tij në Maqedoni të Veriut. Historia e re e shqiptarëve është e shkruar me shumë mund, vuajtje, djersë dhe gjak. E kanë shkruar Heronjtë e Kombit dhe Martirët e Kombit të udhëhequr nga Bacë Adem Demaçi dhe Adem Jashari. Albini duhet ta lexojë me kujdes këtë histori duke mësuar nga ajo. Nuk ka tjetër mundësi apo tjetër rrugë!

26 vjet që nga dalja e parë publike e UÇK-së në Drenoc të Rahovecit

RAHOVEC, 26 PRILL - Të premten u bënë 26 vjet që nga dalja e parë publike e UÇK-së në Drenoc të Rahovecit.

Drenoci ishte pikënsija e UÇK-së për Zonën Operative të Pashtrikut, prej ku do të dilnin shumë heronj dhe dëshmorë trima, që do të sakrifikoheshin për lirinë e Kosovës. "Kushtimit të lirisë nga Drenica e Adem Jasharit e Ahmet Delisë dhe e Shaban Polluzhës iu përgjigjën djemtë e Gllogjanit të Dukagjinit flakë për flakë më 24 mars 1998, ndërsa djemtë e Anadrinisë u bashkuan me jehonën e pushkëve të lirisë më 26 prill të vitit 1998, pikërisht këtu në Drenocin historik. Jehonës së pushkës së Mensur Zyberajt të vellëzërve Bedrush e Feim Gashi, Milaim Krasniqi, Tafil Zyberaj, Sakip Bellaqja, Përparim Thaçi, Naser Krasniqi, Isuf Berisha dhe shumë të tjerë, iu bashkuan dhjetëra e mijëra djem dhe vajza, duke i vënë gjokset e tyre në mbrojtje të atdheut. Flaka e lirisë shumë shpejt do të përhapej gjithandej në Anadri, ku kishte kohë që po vepronin

grupe të organizuara që i konsiderojnë çlirimtarësh. Përveç këtyre vend u projektua edhe marrëveshja për bashkimin e potentialeve njerëzore e luftarakë ndërmjet UÇK-së e LKÇK-së, ku kontribut të madh ka dhënë përfaqësuesi udhëheqës i LKÇK-së, Sabit Gashi, si dhe luftëtari i madh, tashmë heroi i kombit, Fehmi Lladrovci”, ka thënë kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi.

Ai ka thënë se përkundëri faktit se ishim shumë të pabarabartë me armikun, shumë herë më pak të pajisur, kulmoi guximi ynë për të luftuar e sakrifikuar për jetë më të dinjitetshme në liri. "Lufta jonë çlirimtare mori përmasa kombëtare dhe s'kishte si të ishte ndryshe, sepse shqiptarët ndiejnë të njëjtën dashuri për atdheun, pavarësisht se ku jetojnë. Bijat dhe bijtë e këtij vendi u reshtruan në radhët e UÇK-së dhe në forma të ndryshme kontribuuani për të mirën e përgjithshme. Dalja e UÇK-së më 26 prill e më pas beteja e parë frontale në Anadri, e fituar në ditën e 12 majit dhe e

ajo 14 majit, si dhe betejat që pasuan, i dhanë kësaj lufte tjetër dimension. Toka 'u stolis me varre', por nga ai gjak mbinë filizat e shpresës që do të jatin frutat e ëmbla të lirisë që po i shijojmë sot", ka theksuar Latifi.

Ai ka thënë se ngjarje si kjo nabi
bëjnë të ndihemi krenarë që i
takuam asaj epoke të lavdishme,
epokë që ndryshoi historinë, jo
vetëm atë shqiptare, por edhe
hartën e botës. "Prandaj duhet ta
nderojmë e kujtojmë lavdinë e

Kryetari i Prishtinës pret në takim Bekim Jasharin, diskutojnë për shtatoren e komandant Adem Jasharit

PRISHTINË, 26 PRILL - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka zhvilluar takim me Bekim Jasharin, për të diskutuar rreth përzgjedhjes së lokacionit për shtatoren e

komandantit Adem Jashari. "Kënaqësi e madhe të takohesha me Bekim Jasharin. Bashkë diskutuan për zgjedhjen e lokacionit dhe angazhimin e familjes

Jashari në procesin e krijimit të monumentit të heroit të kombit, Adem Jashari. Për kryeqytetin, është njëkohësisht një privilegj dhe përgjegjësi e madhe të

kemi shtatoren e heroit tonë dhe të nderojmë sakrificën e familjes Jashari për lirinë që ne sot gjëzojmë", ka shkruar Rama në "Facebook".



UP-ja promovon veprimtarinë e vet botuese në Panairin Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor në Tiranë

PRISHTINË, 26 PRILL - Universiteti i Prishtinës ka promovuar suksesshëm veprimtarinë e vet botuese në Panairin III Mbarëkombëtar të Librit Akademik e Shkencor në Tiranë përmes prezantimit të botimeve të veta, që përfshijnë libra universitarë, monografi shkencore e fjalor enciklopedik unik, të cilat mbulojnë një spektër të gjerë të fushave si shkencat e natyrës, filologjinë, jurisprudencën, mjekësinë, edukimin e të tjera, që kanë tërhequr interesimin e komunitetit shkencor dhe vizitorëve të shumtë të panairit. Në një aktivitet të veçantë, në kuadër të panairit, Universiteti i Prishtinës ka promovuar librin "E Drejta e përbërbarimit", i cili u promovua nga recensenti prof. dr. Ardit Gashi, është një tekst voluminoz, i organizuar në 25 kapituj, që ka ardhur si aktivizimi i autorit për ta plotësuar mungesën e literaturës në gjuhën shqipe të fushës përkatëse, qoftë për studentët, qoftë për praktikuesit e drejtëpërdrejtë të rregullave të përbërbarimit. Njohësit e jurisprudencës, përkizati me këtë libër, kanë vlerësuar se qasja profesionale dhe akademike e autorit ka prodhuar një tekst unik që ofron qasje bazike, konceptuale dhe shpjeguese të masave dhe zbatimit të përbërbarimit dhe detaje të tjera, të shumëpritur nga studentët dhe i tërë komuniteti akademik dhe ai nga sistemi

promovim të dijes e shkencës, si dhe përgëzoj stafin akademik dhe hulumtuesit e universitetit për punën ekzemplare që u prezantua në këtë panair, ndërkohë me një fjalë përrshëndetëse u paraqit edhe kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, që shprehu kënaqësinë që po merrte pjesë në promovimin e punës shkencore të profesoratit të Universitetit të Prishtinës.

Libri "E drejta e përbërbarimit", i cili u promovua nga recensenti prof. dr. Ardit Gashi, është një tekst voluminoz, i organizuar në 25 kapituj, që ka ardhur si aktivizimi i autorit për ta plotësuar mungesën e literaturës në gjuhën shqipe të fushës përkatëse, qoftë për studentët, qoftë për praktikuesit e drejtëpërdrejtë të rregullave të përbërbarimit. Njohësit e jurisprudencës, përkizati me këtë libër, kanë vlerësuar se qasja profesionale dhe akademike e autorit ka prodhuar një tekst unik që ofron qasje bazike, konceptuale dhe shpjeguese të masave dhe zbatimit të përbërbarimit dhe detaje të tjera, të shumëpritur nga studentët dhe i tërë komuniteti akademik dhe ai nga sistemi



gjyqësor. Ndërsa libri "Qëndrueshmëria mjedisore dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshmë", që u promovua nga recensenti prof. dr. Mihallaq Qirjo, është tekst që trajton një prej sfidave më të mëdha me të cilat po përballet planeti sot: zhvillimi i qëndrueshmë. Ekspertët vendorë dhe ata ndërkombëtarë kanë konkluduar për këtë libër se autor, përmes kombinimit të aspektave akademike të fushës së mjedisit me aspektet e mësimdhënies dhe të nxenit, ka

ofruar një tekst që do të shërbejë si platformë kredibile për adresimin e çështjeve të qëndrueshmërisë ekologjike dhe edukimit të vazhdueshmë për mjedisin. Theskojmë se për të tretin vit me radhë Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" është ftuar dhe po merr pjesë në Panairin Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor, që është projekt i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në bashkëpunim me

Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit - Tiranë. Në panairin e këtij viti Universiteti i Prishtinës i ka prezantuar 20 botime akademike, të botuara ndërmjet dy panaireve, trembëdhjetë nga të cilat i ka përkrahur financiarisht, përmes një projekti financimi që ka për qëllim pikërisht nxitjen dhe përkrahjen e stafit akademik dhe hulumtuesve tanë për t'i konsideruar tekstet universitare si opsjon për prezantimin e të arriturave të tyre shkencore.

Prindërit kanë rol kryesor në vaksinimin e fëmijëve

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 PRILL - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ka theksuar se prindërit kanë rol kryesor në vaksinimin e fëmijëve për ta mbrojtur dhe përparruar shëndetin e tyre dhe për të siguruar mjedis social që siguron mirëqenien e tyre. "Informimi dhe edukimi i prindërvë për detyrimet që ata kanë në raport me shëndetin e fëmijëve të tyre është mënyra më e drejtëpërdrejt për të siguruar për ta informacionin e besueshëm, që t'i

vaksinojnë fëmijët dhe t'i mbrojnë ata nga sëmundjet infektive që mund të parandalohen përmes vaksinimit", ka njoftuar IKShPK-ja. Kosova ka aplikuar gjatë këtij viti tre vaksina të tjera në kalendarin e regjult të vaksinimit: Vaksinën kundër Human Papilloma Virusit (HPV), e cila parandalon më shumë se 90 % të kancereve të lidhura me Human Papilloma Virusin, që është shkaktari më i shpeshtë i kancerit të qafës së mitrës; Vaksinën kundër Pneumokokut (PCV), që mbron nga shkaktarët e sëmundjeve, si pneumonia (infeksion i

mushkërive), meningiti dhe bakteremia (sepsa); Vaksinën kundër Rotavirusit (Rota) për t'i mbrojtur fëmijët, sidomos fëmijët e vegjël para se të arrijnë moshën 5-vjeçare nga ky virus që shkakton diarre, të vjella, dhimbje barku dhe temperaturë të lartë. "Angazhimi i prindërvëve nga të gjitha komunitetet në biseda konstruktive, duke ndarë me ta informacione të besueshme, i ndihmon ata që të kujdesen dhe të sigurohen që fëmijët e tyre t'i marrin të gjitha vaksinat e parapara në Kalendarin e rregullt të vaksinimit", ka njoftuar IKShPK-ja.



Ahmeti kujton Fadil Vatën në 34-vjetorin e vdekjes

PRISHTINË, 26 PRILL - Në 34-vjetorin e vdekjes së Fadil Vatës, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, e ka kujtuar ideologun e Lëvizjes Çlirimtare. "34 vjet pa udhëheqësin e ideologun e

Lëvizjes Çlirimtare, Fadil Vata. 34 vite na ka frymëzuar, na ka udhëzuar e na ka udhëhequr emri i Fadil Vatës, vepra dhe vizioni i tij se si të punojmë për Kosovën, si të luftojmë

për lirinë, si ta çlrojmë e ndërtojmë shtetin e Kosovës. Lavdi e përfjetshme për shokun, mikun, vëllain, veprimtarin, udhëheqësin Fadil Vata!", ka shkruar Ahmeti në "Facebook".



Abdixhiku takon 52 afaristët më të mëdhenj në Shtime: Kosova mundet më mirë!

SHTIME, 26 PRILL - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka qëndruar të premten në qytetin e Shtimes. Ai ka takuar përfaqësuesit e 52 bizneseve më të mëdha të kësaj komune. "Aty pata takim me 52 bizneset më të mëdha të kësaj komune. Dëgjova për

pikëpamjet dhe brengat e tyre; siç dhe u prezantova projektet kryesore ekonomike të 'Rrugës së re'. Prezenca e madhe e tyre ishte shenjë e një lidhjeje natyrale që si parti e djathë kemi me sektorin privat; ndërsa bashkëbisedimi i hapur ishte një mundësi e re drejt përafrimit tonë të

vërtetë", ka shkruar ai në "Facebook". Abdixhiku ka thënë se Kosova është shumë e pasur për të qenë kaq e varfër. "Kosova ka njerëz, iniciativë e sektor privat që mund ta bëjnë zhvillimin fare të lehtë! Fatkeqësisht, mungesa e ambicies së popullistëve ka

shkaktuar mungesë të investimeve qeveritare. Mungesa e investimeve ndërsa ka vendosur vendin në deficit rekord tregtar 5 miliardësh, inflacion rekord 30% e rritje ekonomike më të ulëtët në paspavarësi. Kosova mundet më mirë! Do ta bëjmë më mirë!", ka theksuar Abdixhiku.



"Elektrosever"-i fillon vendosjen e njehsorëve të rrymës në veri

PRISHTINË, 26 PRILL - Kontraktori i KEDS-it, "Elektrosever", ka filluar vendosjen e njehsorëve smart (të mençur) në pjesën veriore të vendit. Këta njehsorë, që janë fjalë e fundit e teknologjisë, do të rregullojnë tutje distribuimin dhe furnizimin me energji elektrike për konsumatorët e Kosovës të asaj pjese.

Në procesin që ka filluar të premten do të vendosen gjithsej 5 000 njehsorë smart me fokus te konsumatorët që kërkojnë lidhje të reja dhe tek ata që nuk kanë njehsorë. Operimi me njehsorët smart është treguar tejet efikas dhe ka avancuar në mënyrë të vazhdueshme shërbimet dhe sigurinë e shpërndarjes dhe furnizimin me energji elektrike për konsumatorët. Rrjedhimisht, avantazhet dhe mundësitet që ofrojnë këta njehsorë janë të shumta.

KEDS-i deri tash ka vendosur mbi 100 mijë njehsorë të tillë anekënd territorit të vendit. Ky shërbim është pjesë e sistematizimit edhe të

konsumatorëve në veri të vendit dhe paraqet një hap të madh përparrë përfundimin më mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirës përfundit.

Integrimi elektroenergetik i pjesës veriore të vendit filloj në pjesën e parë të dhjetorit të vitit të kaluar kur KEDS-i kishte nënshkruar kontratën me "Elektrosever"-in me qëllim të normalizimit të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike në komunat Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan dhe Mitrovicë-Verojë.

Kjo kontratë përkon me ligjin e Kosovës dhe kornizën irregullative, në përputhje me marrëveshjet në lidhje me Energjinë të datës 8 shtator 2013 ("Marrëveshjet e Energjisë 2013") dhe Konkluzionet e Lehtësuesit të BE-së përfundimin e Marrëveshjes së Energjisë të vitit 2013, të datës 25 gusht 2015 ("Marrëveshjet përfundimtare të vitit 2015"), si dhe Udhërrëfyesin përfundimtare të Marrëveshjeve Energetike të 21 qershorit 2022.



"Termokos"-i përmbylli sezonin e ngrohjes



PRISHTINË, 26 PRILL - Ndërmarrja "Termokos" ka njoftuar se në harmoni me parashikimet meteorologjike përmirësimin e motit, ka përmbyllur sezonin ngrohës 2023/2024. "Pas 195-ditësh furnizim të mjafthueshëm dhe cilësor me ngrohje përfundit 30 mijë konsumatorë, përfundon një nga sezonet më të sukseshme ngrohëse, në kuadër të cilës ndërmarrja ka shënuar një varg arritjesh në të gjitha fushat. Gjatë sezonit ngrohës 2023/2024 janë prodhuar rrëth 328 mijë MWh energji termike apo 7% më shumë

se sezonën e kaluar, nga KEK-u janë ekstraktuar 303.15 GWh energji, që në raport krahasues me sezonin ngrohës paraprak ka një rritje prej 14.6%, ashtu sikur edhe tek lifierimi i energjisë termike, që ka qenë 270 GWh. Rrjeti i ngrohjes është zgjeruar edhe përfundit 317 objekte banesore me 13.313 njësi banimi dhe me një sipërfaxë totale prej 1,122,538.00 m², ka njoftuar "Termokos"-i. Sipas këtyre njoftimit, ky sezon ngrohës ka qenë fazë testuese para fillimit të aplikimit të metodës së re të faturimit sipas konsumit. "Si rrjedhojë e testimeve,

analizave e krahasimeve, që janë realizuar, tanimë mbi 1 mijë konsumatorë i kanë marrë faturat e para testuese sipas konsumit, bazuar në të cilat 33% e konsumatorëve si rezultat i kursimit të energjisë ngrohës e kanë pranuar fatura më të ulëta se ato që kanë marrë më parë. NP 'Termokos' do të vazhdojë të angazhohet përfundimtare të modernizimin e mëtutjeshëm të shërbimeve dhe realizimin e projekteve të shumta, që do të kenë ndikim të shumëfishtë pozitiv në mirëqenien e qytetarëve tanë", ka njoftuar "Termokos"-i.

Për tre muaj diaspora i dërgoi 284 milionë euro në Kosovë

PRISHTINË, 26 PRILL - Mbi 112 milionë euro është vlera e dërgesave të mërgatës që janë sjell në Republikën e Kosovës përfundim mars 2024. Kështu thuhet në statistikat e remitancave dhe institucioneve të tjera financiare përfundimtare, të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), duke shtuar se vlera totale e tyre përfundimtare më shumë se 314.83 milionë euro, duke shënuar rritje prej 2.11 milionë eurosh.

Sipas raportit, prurjet më të mëdha të remitancave ishin nga institucionet financiare jobankare me pjesëmarrje prej 64.46-përqindësh, pasuar nga kanalet e tjera me 23.34 përfundimtare dhe bankat me 15.20 përfundimtare.

Për sa iu përket aseteve të kompanive të sigurimit, BQK-ja tregon se deri në këtë muaj vlera e tyre ishte 314.83 milionë euro, duke shënuar rritje prej 2.11 milionë eurosh.

krahasuar me shkurtin e 2024-s.

Ndërsa asetet e fondeve pensionale kanë arritur vlerën e 2.87 miliardë euro, e cila përfaqëson rritje përfundit 74.14 milionë euro. Në fund, BQK-ja tregon se asetet e ndërmjetësve të tjerë financiare në fund të muajit mars 2024 janë rritur përfundit 9.26 milionë euro, duke arritur vlerën e 564.49 milionë eurove.



Paraqitja e tmerrshme e Mbretëreshës së ndjerë flet për fundin e epokës së statujave

Lindja e modernizmit duhej të kishte shënuar fundin e monstruozitetave. Por, pse insistojnë të vazhdojnë në këtë mënyrë?

Nga: Ben LAWRENCE /
The Daily Telegraph

Fundjavën e kaluar, në Ratlend u zbulua statuja e parë në Britani e të ndjerës Elizabeth II. Nuk isha atje, mirëpo, pasi i pashë fotografitë, mund të supozoj se vizitorët mbetën me gojë të hapur – por, jo sepse u mahnitën. Është e tmerrshme: e shëmtuar, punim torollak dhe paksa i frikshëm. Artisti Hywel Pratley e ka shndërruar mbretëreshën e ndjerë në hukubet të tmerrshëm, duke e veshur me një fustan vajzëror që e bën të duket si Titanianë [mitike – shën. i Telegrafit], por e shkurtë dhe topolake, ose si një karakter nga [filmi i animuar] Frozen me disa nuanca të vocërrakes Jimmy Krannie [Janette Tough në karakterin Wee Jimmy Krannie në kabaretë televizive të viteve 1970-'80].

Njëloj të papëlqyeshëm janë ata [qenushët] korgi që mblidhen te këmbët e saj, ku njëri mbështet putrat në bazament. Këto detaje janë përkujtues të vegjël dhe të tmerrshëm se tashmë jemi në epokën e së lezetshmes dhe se rëndësia e cilësisë është zëvendësuar nga simpatikja. I bën të pakënaqurit e vjetër si unë të ndihen thuaçse vazhdimisht po sulmohen nga një Hello Kitty gjigante [nga karakteri i maces i krijuar nga japonezja Yuko Shimizu] që fryhet me ajër. E shikoj këtë statujë dhe ndihem i sigurt se Mbretëresha e ndjerë – e cila njihej për arsyen e saj të shëndoshë dhe neverinë ndaj sentimentalizmit – do ta kishte urryer.

Nuk është befasi iniciativa e

mjerë e Pratleyt. Nuk mund të mendoj për një statujë të vetme të mirë që është ngritur në këtë shekull. Ka disa arsyë për këtë. Së pari, statujat – ose të paktën ato me një shkallë të caktuar realizmi – nuk kanë asnjë qëllim në shekullin XXI. Gjërat ishin më ndryshe në epokat e mëparshme, kur njerëzit kishin pak ide se si dukej subjekti i një statuje, ndërsa përfaqësimi i tyre në metal ose në gur shpeshherë bëhej imazh zyrtar – vlera kryesore në ikonografinë e tyre. Por, ardhja e fotografisë dhe më pas e televizionit, do të thotë se temat moderne tashti i njohim jashtëzakonisht mirë.

Mbretëresha e ndjerë ishte gruaja më e fotografuar në botë,



viteve të fundit kanë akumuluar mjaft storje nga lajmet. Kemi parë se [tregtar i sklevërve] Edward Colston u përmbyt në Bristol dhe u ekspozua sërisht thuajse e ka marrë veten nga sulmi. Në Kolegjin Oriel, në Oksford, prania

harruar, do të akuzoheshim se kemi harruar mijëra të tjera që janë mbërthyer nga shtrembërimi dhe nga indi i së kaluarës sonë.

Problemi më i madh me statujat moderne është se janë të tmerrshme. Shpeshherë janë konceptuar keq. Shpërfytyrimi më i fundit, sipas meje, është paraqitura e Mary Wollstonecraftit në Njuington-Grin në veri të



Statuja qesharake e Harry Kaneit

gjë që përforcohej nga paraqitura e saj në pulla postare, në bankënota dhe shumë gjëra të tjera të përditshme: çdo projekt që synon të paraqes sërisht ngjashmërinë e saj, e ka fatin e keq të dështojë. Jam i lumtur kur përhumbem në Kopshtet e Viktorisë [Victoria Embankment Gardens] në Londrën qendrore, ku statuja e dikujt që njoh në mënyrë të paqartë, si [kleriku dhe filantropi] Robert Raikes, më vështron me pëershkrimin e dikujt që njeh punën e vet. Është çështje krejt tjetër kur e viziton Seleronin në Nju-Jork dhe ballafaqohesh me pamjen e tmerrshme të Lucille Ballit nga Dave Poulin, një punim që ka ngjashmëri me komedianen e famshme amerikane po aq sa ka edhe me mua. Kur bëhet fjalë për statujat, gjërat që njohim ngjallin përbuzje. Nuk është çudi që këshilli i Uelthemstout fshehu skulpturën e të gjorit [futbollist] Harry Kane.

Pastaj është natyra e rrëshqitshmë e historisë. Statujat nga e kaluara, siç të gjithë jemi shumë të vetëdijshëm, gjatë

monolite e manjatit [kontrovers të minierave] Cecil Rhodes, ka shkaktuar periudha të zakonshme neverie dhe, megjithëse kolegji vendosi të mos largojë, Antony Gormley – skulptori më i shquar i gjallë i Britanisë – sugjeroi se ai nga turpi duhet ta kthejë kokën kah muri. Ndërkohë, në Granthem, statuja e Margaret Thatcherit në disa raste është vandalizuar.

Por, problemi nuk kufizohet vetëm në debatet për figurat e diskutueshme. Historia, si disiplinë, ndjeshëm ka ndryshuar në pjesën e dytë të shekullin e kaluar: nuancat e ofruara sot nga historiografia, ku studimi i historisë së shkuar konsiderohet po aq i rëndësishëm sa vetë ngjarjet, do të thotë se "poza" e një statuje kap vetëm një element psikologjik të një figurë komplekse. Vetë akti i përkujtimit të dikujt duket se po shkon kundër pikëpamjes sonë bashkëkohore e cila favorizon grupet mbi "burrat e mëdhenj" (ose gratë). Nëse do të ngrinim një statujë përnder të një sufragete [luftëtareje për të drejtën e grave përvotuar], të

Shumë nga këto statuja janë komike dhe të shëmtuara, madje të frikshme; dhe është e vërtetë se gjatë historisë, shkrimtarët dhe artistët kanë parë potencialin e veprave të tilla artistike për të na rrëmbyer. Mendoni për Don Xhovanin e Mozartit në të cilin Il Komendantore vritet në një duel dhe kthehet që të ndjek torturuesin e vet – në formën e një statuje të mbinatyshme guri; ose fantazitë e fëmijëve të Edith Nesbitit, të tilla si Kalaja e magjepsur në të cilën Ketlina e re, teksha mban një unazë magjike që plotëson dëshirat, dëshiron të jetë statujë dhe sheh veten të ndarë nga vëllezërit dhe nga motrat e veta – e bllokuar në botën tmerrësish të frikshme të poshtme të mermerit. (Kërcënimi, pa dyshim, vjen më shumë nga insinuata se statuja është një lloj gjysmë-fantazme sesa ndonjë shëmti estetike, gjë që është



Marry Wollstonecraft sipas Maggi Hamblingut

Londrës, nga Maggi Hambling – e cila e reduktoi nënën e valës së parë të feminizmit në një palë gjinjsh. Ashtu si statuja e Oscar Wildeit e Hamblingut – që shfaq Oscarin e dashur që ngrihet nga arkivoli për të pirë cigare – është e tejartikular dhe e marrë. Të tjerat janë monstruoz në mungesën e emocioneve. Edhe diçka aq e padëmshme sa monumenti i Gillian Wearingut i vitit 2018, dedikuar [aktivistes sufragete] Millicent Fawcettit në Sheshin e Parlamentit, është fyeze në mënyrën e vet: një shësesë e panevojshme për një qytet në të cilin përkujtimi tashmë është mani.

arsyeja më e mundshme se pse do të tërboheni kur shihni përbindëshat e vërtetë prej bronzi që po mbushin Britaninë.) Duke marrë parasysh të gjitha këto, do të thosha se epoka e statujës ka vdekur. Në të vërtetë, duket se ajo është zhdukur që me lindjen e modernizmit i cili supozohej të gjerryente pëershkrimin e kotë literal të cilin kaq shpesh e shohim te veprat e artit si këto. Nëse duhet t'i nderojmë individët, në të ardhmen, atëherë le t'i bëjmë ternerësht abstraktë – dhe, ju lus, pa qentë korgi që kërcejnë. Përkthimi: Telegrafi.com





spor



Ndeshje të vështira për Ballkanin, Dritën dhe Llapin

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 26 prill - Tri skuadrat e para në tabelë, Ballkani, Drita dhe Llap, kërkojnë fitore në javën e 31-të të Superligës për të mbetur në garë për titull edhe në xhirot e fundit të këtij edicioni. Punë të vështira i presin këto klube, pasi të tria luajnë në terrene mysafire ndaj kundërshtarëve të papërshtatshëm. Ballkani, pas barazimit në xhiron e kaluar me Dritën dhe barazimit në gjysmëfinalen e dytë ndaj Suharekës, i shkon Gjilanit nga i cili synon tri pikët e plota. Aktualisht kampionët në fuqi kanë dy pikë më shumë se dy skuadrat përcjellëse dhe tri pikë do të ishin shumë të mirëseardhura për ta. Drita, që dështoi të kualifikohet në finale të Kupës, do të mundohet të këndellet në përballje me Dukagjinin në Klinë. Dukagjini është në mesin e tabelës dhe pa



pretendime të mëdha, por skuadra kryesuese ka ditur t'u shkaktojë shumë telashe. Ndeshja kryesore pritet të jetë ajo mes Prishtinës dhe Llapit, e cila do të zhvillohet në stadiumin "Ramiz Sadiku" në

Prishtinë. Të tri këto skuadra që janë në garë për titull ndeshjet i zhvillojnë të dielën, kurse sot (e shtunë) zhvillohen dy ndeshje të tjera. Fushë-Kosova, që është afër të humbasë edhe matematikisht garën për

mbijetësë, e pret skuadren e Lirisë, e cila tashmë zyrtarisht e ka humbur statusin e skuadres elite për kampionatin e ri 2024/2025. "Pampurat" janë favoritë dhe presin fitore ndaj prizrenave. Në ndeshjen tjetër

SUPERLIGA - Java 31-të

Të shtunën takohen:
15:00 Fushë Kosovë - Liria
15:00 Feronikeli 74 - Malisheva

Të dielën takohen:
15:00 Prishtina - Llap
15:00 Gjilani - Ballkani
15:00 Dukagjini - Drita

	Tabela	Pikë
1. Ballkani	30	60
2. Drita	30	58
3. Llap	30	58
4. Malisheva	30	52
5. Prishtina	30	43
6. Dukagjini	30	38
7. Gjilani	30	34
8. Feronikeli 74	30	31
9. Fushë Kosova	30	20
10. Liria	30	11

në Drenas, Feronikeli 74 e pret Malishevë. Këto dy skuadra me një rivalitet të theksuar do të kërkojnë fitore, ndërsa "Nikli" ka nevojë më shumë për pikë në mënyrë që të jetë më i qetë në renditjen tabelore.

Priten ndeshje të zjarra në turneun final të Kupës në Hendball



Pejë, 26 PRILL - Skuadrat më të mira të hendballit në vend e kanë kthyer gjithë fokusin te turneu final i Kupës së Republikës së Kosovës. Turneu final i Kupës, përkatësisht ndeshjet gjysmëfinale dhe finalet, është vendosur të luhen në palestrën "Karagaç" në Pejë. E shtuna dhe e diela do të janë të mbushura me ndeshje të forta e cilësore të hendballit. Tashmë është caktuar edhe orari i ndeshjeve. Fillimi sot (e shtunë) në

program janë dy gjysmëfinalet te hendballistet. Nga ora 14:00 takohen Vushtria dhe Istogu. Istogu është fitues në fuqi i Kupës dhe llogaritet favorit. Ndërsa nga ora 16:00 është ndeshja Ferizaj - Samadrexa. Të dy skuadrat kanë pretendime të mëdha dhe pritet ndeshje dramatike. Më pas janë ndeshjet gjysmëfinale te hendballistët. Fillimi prej orës 18:00 takohen Trepça e Kastrioti. Trepça është fituese në fuqi e Kupës, por Kastrioti e synon

finalen e madhe. Pritet ndeshje, po ashtu, interesante. Ndeshja kryesore e ditës zhvillohet prej orës 20:00. Takohen Rahoveci dhe Besa Famgas. Këto dy skuadra kanë luajtur katër ndeshje shumë të forta në stinorin e rregullt. Të gjitha ndeshjet janë vendosur në aksionet e fundit. Njëjtë pritet të jetë edhe të shtunën mbrëma në "Karagaçin" e Pejës. Shpresohet në numër të madh shikuesish që spektakli i Kupës të jetë i kompletuar.

Sonte përballen Peja - Ylli, nesër Trepça - Prishtina

Pejë, 26 PRILL - Në fundjavë do të zhvillohen ndeshjet e treta gjysmëfinale të "play-off"-it në Superligën e Kosovës në basketboll. Sot (e shtunë) në palestrën "Karagaç", Peja do ta presë Yllin për aktin e tretë gjysmëfinal. Në dy ndeshjet e para mes këtyre dy skuadreve

ka triumfuar Ylli dhe kjo ndeshje është mundësia e vetme për klubin kampion që të mbetet në garë.

Nesër (e diel) në palestrën "Minatori" në Mitrovicë, Trepça do ta presë Sigal Prishtinën. Mitrovicasit i kanë fituar dy përballjet e para. Nëse

e fitojnë edhe ndeshjen e tretë, kualifikohen në finalen e madhe.

TË SHTUNËN TAKOHEN:
19:00 Peja - Golden Eagle Ylli

TË DIELËN TAKOHEN:
19:00 Trepça - Sigal Prishtina



Gjakova dhe Cena eliminohen nga Evropiani i Xhudos

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Dita e premte nuk ishte e sukseshme për xhudon e Kosovës, pasi dy garuesit, Akil Gjakova dhe Dardan Cena, janë eliminuar nga Kampionati Evropian i Xhudos që po mbahet në Zagreb të Kroaciës.

Akil Gjakova u eliminua pasi pësoi humbie nga xhudisti bullgar Mark Hristov me Wazari, në kategorinë deri në 73 kilogramë. Më herët është eliminuar edhe xhudisti Dardan Cena që pësoi humbie nga italianni Manuel Parlati në

raundin e dytë në kategorisë deri në 73 kilogramë. Të enjten Distria Krasniqi është shpallur kampionë e Evropës në xhudo në kategorinë deri në 52 kilogramë. Kampioni olimpike në finale imposhti xhudisten italiane Odette Giuffrida me waza-ari.



Nadal: Nëse lëndohem sërisht, karriera ime merr fund

MADRID, 26 PRILL - Tenisti spanjoll Rafael Nadal është rikthyer në fushë me shpresën që të fitojë minuta të rëndësishme për të qenë gati për grand slam e Roland Garros. Fituesi i 22 grand slamit po luan në turneun

Masters të Madridit, ku fitoi në raundin e parë ndaj një 16-vjeçari. Tani nisin për Nadalin sfidat e vërteta, ndaj spanjollit shpreson të luajë sa më shumë dhe të jetë në formë për eventet kryesore. "Nuk e mohoj që

Roland Garros dhe Olimpiada janë dy objektivat e mi kryesorë përkëtë vit, por s'kam vendosur ende", ka thënë Nadali. "Dua të jem në 100 % në formë para se të vendos të luaj në Paris. Gjithsesi, një gjë e di

me siguri. Nëse lëndohem sërisht, atëherë karriera ime ka marrë fund përfundimisht. Shpresoj të bëj një paraqitje sa më të mirë dhe ta testoj veten deri në fund", ka dekluarar Nadali.



Terry për Mourinhon: Na tmerroi në fillim, por tregoi se ishte gjeni

LONDËR, 26 PRILL - Ish-futballisti dhe kapiteni i Chelseat, John Terry, kujtoi sezonin e parë të Jose Mourinhos në klubin londinez, duke rrëfyer se lojtarët ishin "të tmerruar" pas konferencës së parë për shtyp të trajnerit portugez. "Në fazën parasezonale të parë me Mourinho ne qëndruam në Angli për disa ditë para se të shkonim në Los Angeles. Seancat e para stërvitore ishin një mundësi e shkëlqyer përti bëre përshtypje, sepse të gjithë ishim të tmerruar me atë që dëgjuam në konferencën e tij të parë për shtypin. Ishim të gjithë të turbullt, u lidhëm me njëri-tjetrin. Nuk dinim çfarë të prisnim. Ishte frikësuese të shihje se sa i sigurt ishte ai", ka thënë Terry. Ish-mbrojtësi anglez vlerësoi punën e Mourinhos, që ndryshoi tërësisht mentalitetin te Chelseat. "Më pëlqen mënyra se si ai krijoj mentalitetin e botës kundër Chelseat. Më kujtohet dita e parë e punës. Mendova se kam ardhur gjithmonë herët. Unë isha në mensë dhe ishte jashtë, në fushë,



duke vendosur konet e stërvitjes dhe duke rishikuar atë që do të bënim në shënimet e tij. Ai na tha: 'Ne do ta fitojmë kampionatin këtë vit'. Ishte shumë e thjeshtë. Ai donte që ne të punonim shumë dhe më pas u tha medieve se lojtarët e tij ishin më të mirët në botë. Nuk na i kishin thënë kurrrë këto gjëra. Na bëri të ndihemi

shumë të veçantë", ka dekluarar Terry. "Mënyra se si ai i analizoi kundërshtarët taktilisht ishte në një nivel që unë ende nuk e shoh sot. Ai është një gjeni absolut. I kam ditur emrat e të gjithë arbitrave, udhëzimet që ka dhënë kundërshtari për ekipin tonë, fëmijët e trajnerëve...", ka dekluarar Terry.

Lakersat, afër eliminimit nga 'play-off'-i



DENVER, 26 PRILL - Kampionët e Denverit janë pranë kualifikimit në gjysmëfinalet "play-off" në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 112-105 ndaj lakersave në çerekfinalen e tretë. Lakersat, edhe pse luajtën në fushën e tyre, nuk arritën të fitojnë, ndërkokë që Denveri është një fitore larg kualifikimit. Katër lojtarë të skuadrës së

Denverit realizuan mbi 20 pikë, ku shkëlqeu Gordoni, autor i 29 pikëve dhe 15 reboundeve. Për lakersat, Davisi e mbylli ndeshjen me 33 pikë e 15 rebounde e Le Bron Jamesi me 26 pikë, por që s'mjaftuan përtë fituar. Dy ndeshje të luajtura në Konferencën e Lindjes. Skuadra e Philadelphias fitoi me rezultat 125-114 ndaj New Yorkut, duke

rihapur garën. Joel Embiid ishte një përbindësh përvendasit, autor i 50 pikëve, duke i bërë të pavleshme 39 pikët e Brunsonit për nju-jorëzët. Fitoren e parë në këto çerekfinale e korri edhe Orlando, që mundi me shifrat 121-83 Clevelandin, që tashmë udhëheq 2-1 me ndeshje. Banchero me 31 pikë e 14 rebounde si dhe Suggs me 24 pikë bënë dallimin në fushë përskuadrën vendase.

ÇEREKFINALET - KONFERENA E LINDJES

CLEVELAND - ORLANDO	83-121 (2-1)
NEW YORK - PHILADELPHIA	114-125 (2-1)
BOSTON - MIAMI	(1-1)
MILWAUKEE - INDIANA	(1-1)

ÇEREKFINALET - KONFERENA E PERËNDIMIT

MINNESOTA - PHOENIX	(2-0)
DENVER - LAKERS	112-105 (3-0)
CLIPPERS - DALLAS	(1-1)
OKLAHOMA - NEW ORLEANS	(1-0)

Pedro Rocha, president i ri i Federatës Spanjolle të Futbollit

Pedro Rocha është presidenti i ri i Federatës Mbretërore të Futbollit Spanjoll, siç është rënë dakord nga Komisioni Zgjedhor këtë të premte. Në këtë mënyrë, dhe siç

pohoi vetë lideri ekstremaduran, fitorja e tij elektorale është njohur në mënyrë që në këtë mënyrë dëshmorët e përmomentin, të zbërtuehet një rrjet që ka çuar RFEF-në ta

rrezikojë edhe pjesëmarjen e radhës të Spanjës në Euro Kupa në Gjermani, në rast të ndërhyrjeve të mundshme nga qeveria. 107 miratimet e marra nga Pedro

Rocha janë bërë efektive dhe, në këtë moment, është koha përtë parë dëshmorët e përcaktuar në mënyrë shteruese përbërjen e të ashtuquajturit Komisioni i

Mbikëqyrjes, Normalizimit dëshmorët e përcaktuar në tifozët e Pedro Rocha, të paktën deri në vjeshtën e ardhshme, në udhëtimin e tij me presidentin e RFEF-s.

SHKURT

Vllaznia ndan rrugët me trajnerin Qatip Osmani

Eliminimi në Kupë kundër Egnantias ka sjellë ndarjen përfundimtare mes klubit shkodran, Vllaznia dhe trajnerit Qatip Osmani. "KF Vllaznia njofton të gjithë opinionin sportdashës se ka myllur me mirëkuptim bashkëpunimin me profesor Qatip Osmanin dhe po ashtu edhe me zëvendëstajnerin Bashkim Livoreka. Klubi falenderon përtë gjithë kontributin e dhënë përskuadrën tonë dhe i uron shumë suksese në karrierën e tyre të mëtutjeshme", thuhet në njoftimin e Vllaznisë.

Slot: Dua të drejtoj Liverpoolin

Arne Slot fsheh hapur dëshirën përtë marrë drejtimin e skuadrës së Liverpoolit në sezoni e ardhshëm, pasi Jurgen Klopp do të largohet. "Klabet janë duke negocuar dhe unë jam duke pritur përtë parë se cili do të jetë rezultati. Dua të shkoj në Liverpool, nuk është sekret. Tani jam duke pritur që të kjo klubet të arrijnë një marrëveshje dhe Jam i bindur se kjo do të ndodhë", ka thënë Slot. "The Reds" kanë hapur negociatat me Feyenoordin përtë nënshkrimin e trajnerit holandez, i cili ka edhe dy vite kontratë me klubin aktual. Nëse marrëveshja realizohet, kompensimi ndaj klubit holandez pritet të jetë rrëth 9 milionë euro. Slot pëlqehet përidhë e tij të futbollit agresiv me të cilin riktheu titullin kampion holandez, gjashtë vjet pas herës së fundit, sezoni e kaluar dhe fitoi Kupën e Holandës këtë sezon.

Guardiola: Gara përtitull është e hapur

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola është shprehur i kënaqur me fitoren e thelli 4-0 në udhëtim te Brightonit. "Jap shumë merita sepse e njoh kundërshtarin me të cilin përballemi. Brighton ka qenë duke luftuar me shumë mungesa këtë sezon. Edhe pse ata ende luajnë me guxim dhe nuk dorëzohen kurrë, ata do të vazhdojnë të bëjnë këtë", ka thënë Guardiola. "Por është një rezultat i mirë për ne, shumë i mirë. Ne shënuam katër gola, ky është çelësi. Ne folëm si ekip që nëse nuk do të kishim topin do ta vuanim. Lojtarët e bënë shumë mirë. E thashë më parë, atë që kemi bërë në të kaluarën, nuk do të thotë se do ta bëjmë në të ardhmen. Kanë mbetur edhe pesë ndeshje, ne e dimë se diferençat janë shumë të ngushta. Duhet të fitojmë secilin ndeshje. Çdo ndeshje ne jemi më afër", ka shtuar Guardiola.

I pyetur nëse titulli tani luftohet vetëm mes Manchester Cityt dhe Arsenalit përtitull, Guardiola është përgjigjur: "Nuk është. Ajo që ndodhi me Liverpoolin, dy humbje radhazi, mund të ndodhë me Arsenalin, mund të ndodhë me ne. Ajo që është e rëndësishme është që ne ende jemi atje. Ka shumë lojëra përtë luajtur".

Barça interesohet përtitull Sanen

Barcelona do të duhet të bëjë shitje këtë verë përpëra se të bëjë nënshkrime, dhe veçanërisht ato të mëdha, por katalanasit ende janë duke kërkuar në treg për opsiione që mund të përmirësojnë skuadrën e tyre, ku Leroy Sane është tashmë i pëlqyeri. Sipas "El Chiringuito", javën e kaluar Barcelona i bëri një telefonatë Bayern Münchenit përtë pyetur disponueshmërinë e Sanes këtë verë, megjithëse nuk kishte asnjë mbi përgjigjen "bavareze" rrëth kësaj kërkese. Sane ka vëtëm një viti që mbetur në kontraten e tij me gjigantet gjerman dhe thuhet se është i hapur përtë larguar. Detaje tjera rrëth shumë se sa është e gatshme të paguajë Barcelona përtitullin e tij.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BLISSHOME" Sh.P.K. me seli në Stanovc i Poshtëm, Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811968992 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestanje se svi klienti da drustvo sa "BLISSHOME" D.O.O. od Donje Stanovca, Vuqiterna, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811968992 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "BLISSHOME" L.L.C. with headquarters Stanovc i Poshtëm, Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811968992 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "TECNOMARK" Sh.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811936056 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestanje se svi klienti da drustvo sa "TECNOMARK" D.O.O. od Gjakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811936056 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "TECNOMARK" L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 811936056 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Bimi Diti" Sh.p.k. Zym, Prizren në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë solare fotovoltaike 1 MWp në Gjonaj, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.06.2024 në ora 10:00 në objektin e komunës se Prizrenit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Bimi Diti" Sh.p.k. Zym, Prizren në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni reportin e VNM-së për Kompaninë "Bimi Diti" Sh.p.k. Zym, Prizren për parkun e energjisë solare fotovoltaike 1 MWp në Gjonaj, Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Florian Gashi nga Roga e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të klasës 1-5 dhe 6-9 të SH.F.M.U "Haxhi Hoti", Rogovë.
- Njomza Dervishaj nga Rracaj e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 6-9 e lëshuar nga shkolla fillore e mesme e ultë "3 Dëshmorët", Sheremet-Gjakovë.
- Pjetër Berisha nga Korenica e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 1-8 e lëshuar nga shkolla fillore "Luigj Gurakuqi", Korenicë-Gjakovë.
- Floriana Gashi nga Roga e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të klasës 1-5 dhe 6-9 të SH.F.M.U "Haxhi Hoti", Rogovë.
- Arben Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.T "Nexhmedin Nixha", drejtimi MEKANIK, Gjakovë.
- Enise Shuki shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.
- Nexhmedin Tulla shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Lavdije Sopi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Zef Lush Marku" Velezhe.
- Zylmi Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Edita Beqa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Xhavit Januzi nga Nivokazi KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. Bujqësi "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

Ambienti

KOMPANIJA REGIONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" SH.A PEJË
NR. 632
DATA 26.04.24

Kompania Regionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr. Xhem Sadrija nr. 1, Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8, dhe në bazë të Udhizimit Administrativ MFPT-NR.01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 22.04.2022, shpall konkurs të brendshëm për këto vende punës:

KONKURS

- Pozita : Punëtor Fizik (4 pozita)

Paga ; 410 euro
Kontrat me afat të PA caktuar, kohëzgjatja e periudhës provuses 6 muaj.

Punëtori Fizi ka këto detyra dhc përgjegjësi

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
- Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrzen e kontenjerave dhe mjetetë tjera për hedhurinë apo çesec nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- Pas zbrzjes së Kontenjerave dhe mjetetë tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vendë të caktuarë dhe për to të ketë kujdesë.
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit c shërbimeve.
- Kryen edhe punët tjera me urdhëres Shoferit, Kryepunëtorit
- Për punën e vetë i përgjigjet drjipërdrejtë Shoferit, Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives, Kryeshefit Ekzekutiv

Kushtet:
Shkollimi fillor
Aftesi fizike dhe psikike të dëshmuar
Ai / Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Mënyra e Aplikimit: Dokumentacioni i kërkuar dërgohet nga kandidatet në e-mailin ambientistlog@gmail.com

Vetëm kandidatët e selektuar përfshijnë listën e ngushtë do të kontaktohen konkursi mebetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit. Prej datës 26.04.2024 deri me 13.05.2024 ora 16:00

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

VIDAS

100% Fresh & Natural

VIDAS **DHALLË**

VIDAS **JOGURT**

VIDAS **Schmand** 18% yndyrë

VIDAS **Llatte** drink 2%

VIDAS **TAMËL** PRO DUAR ME FINËSE DHE DASHURI 2,8%

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA
1992

